



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 544/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimic dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat me nr. A-544, A-545 dhe A-546, të datës 13.12.2010, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kundër Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Arsyetim

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar 3 (tre) ankesa, me numër A-544, A-545 dhe A-546, të datës 13.12.2010 e paraqitur nga PDK kundër subjektit politik LDK në të cilat pretendohet se :

Gjatë ditës së zgjedhjeve në shumë shkolla të Prishtinës si SH.M. “28 Nentori”, “Pjetër Budi”, “Ali Sokoli”, “Naim Frashëri”, Ismail Qemajli”, “Iliria”, “Zenel Hajdini”, “Meto Bajraktari”, “Nazim Gafurri””Asim Vokshi”, “Emin Duraku”, e disa të tjera drejtorët e shkollave kanë ndërhyrë në procesin e rregullt zgjedhor. Ndërhyrja e tyre ka qenë nëpër VV pas fillimit të numërimit të votave. Parashtruesi i ankesës ka precizuar shkollën e mesme “Ali Sokoli” si shembull ku drejtori i kësaj shkolle ka ndërhyrë drejtpërdrejt në procesin e numërimit i cili deri në momentin e intervenimit të policisë nuk është larguar.

Po ashtu gjatë ditës së zgjedhjeve në QV1906 në Fakultetin Filologjik në Prishtinë anëtari i KKZ-së Labinot Bajrami nga radhët subjektit politik LDK ka tentuar në mënyrë të vazhdueshme ti largoj nga VV vëzhguesit e PDK-së edhe pse ishin të akredituar. Parashtruesi i ankesës thekson se kishte intervenuar policia dhe anëtarët e KKZ-së për të vazhduar punën vëzhguesi në këtë QV.

Si dhe në shkollën e mesme “Ali Sokoli” në Prishtinë komisionari i LDK-së i cili ka votuar në VV nr.04, kishte tentuar të votoj për të dytën herë në VVnr. 02 ku ishte penguar nga komisionari-kryesuesi Faton Dedinca.

Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që ankesat të shqyrtohen dhe të vendoset sipas akteve juridike në fuqi sepse konsideron se janë shkelje të rënda të procesit zgjedhor nga ana e subjektit politik LDK.

Ne mbështetje të pretendimeve, parashtruesi i ankesave nuk ka bashkangjitur asnjë prove.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) dhe neni 6.3 parashohin si vijon:

3.6 (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

6.3. Me qëllim të lehtësimit të shyrtimeve të ankesave, kryesuesi i panelit mund të vendosë ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vetë çështje të ngjashme, paneli vendimmarrës i trajton ato si kur të ishin një ankese.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

- ankesat janë të pabazuara

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesat e subjektit politik PDK, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullësi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar në dispozitat e lartpërmendura si dhe në kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 544/2010 më datën 16.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

